

## Syllabusi i lëndës

**Lënda:** AKAID II, *Kiameti, koncepti i imanit dhe mëkatarit të madh.*

**Programi i studimit:** Studime Islame

**Numri i ECTS kredive:** 6

**Statusi i lëndës:** Obligative

**Kodi i lëndës:** 201

**Fondi i orëve:** 3+2

**Viti akademik:** 2015/2016

**Semestri:** III

**Mësimdhënësi:** Mr. Naim Tërnavë. Kontakti: e-maili: [naimternava@hotmail.com](mailto:naimternava@hotmail.com)

## Përshkrimi i shkurtër i lëndës

Kjo lëndë ngërthen studimin në besimin e librave të shenjtë, besimi në gjallesa metafizike melek\engjëj dhe exhin, veçoritë e tyre, dhe krahasimi i tyre me njerëzit në adhurime. Besimi në Ditën e Kiametit, dhe jeta e pastajme. Shenjat e vogla dhe shenjat e mëdha të kësaj Dite. Fillimi i llogaridhënies, Xheneti dhe Xhehemi. Doktrinat mbi konceptin e Imanit në sektet e ndryshme si dhe Islamit. Çështja e akuzimit të herezisë. Emrat e bukur të Allahut xh.sh.

## Qëllimi i lëndës

Njohja e studentëve me njohuri bazë nga lëmi i Akaidit\Besimit Islam, parimet themelore siç është besimin në librat hyjnorë, në melek, dhe në jetën e pasme. Zhvillimi i shkathësive dhe aftësive për të analizuar të dhënat e ndryshme mbi besimin të cilat përfshin programi studimor në mënyrë që të mund të nxjerrin konkluzione për to. Fitimi dhe avancimi i sensit të kritikës në aspektin e vlerësimit të argumenteve bazuar në fakte përkatëse në tekstet themelore të besimit islam. Aftësimi për të shkruar ese apo për të diskutuar për to, në një stil të pastër dhe bindës të të shprehurit me gojë dhe me shkrim, tipare këto të një personi me një edukim liberal akademik. Prej leksioneve nga Akadi II semestrit të tretë, presim që studenti pas përfundimit të këtij kursi do të përfitojë njohuri të detajuar mbi librat hyjnorë, melekët, dhe eskatologjinë\ahiretin e besimit islam, si dhe qëndrimet e ndryshme rreth Ditës së Kiametit. Të kuptojë qëndrimet rreth besimit në ringjallje dhe mënyrën e saj. T'i jepet mundësi studentit që në formë kritike duke nxitë debate, t'i kuptoj çështjet ndaj të cilave pati debate të shumta, që edhe ky të kontribuojë në këto pikëpamje. Të kuptojë se zhvillimi i studimit të besimit është në interes të ngritjes së individit dhe shoqërisë në aspektin moral, sepse ia kultivon njeriut humanizmin dhe e bën më të hapur dhe shpirtgjerë në marrëdhëniet ndërnjerëzore.

### **Rezultatet e pritura të nxënies:**

**Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje të:**

Të përshkruaj mënyrën e besimit në librat, melekët, dhe jetën e pasme-ahiret.

Të krahasoj ndërmjet pikëpamjeve të ndryshme ndaj çështjeve të besimit të cilat i studion gjatë kursit.

Të diskutoj rreth çështjeve të besimit islam në bazë të argumenteve esenciale islame, duke qenë sa më objektiv në parashtrimin e tyre.

Të mbroj qëndrimet e pikëpamjeve të ndryshme rreth ringjalljes ashtu siç i konceptojnë ithtarët e tyre.

Të prezantoj mendimin kritik ndaj secilës prej tyre, duke paraqitur atë më të vlefshmin.

Të jetë në gjendje që njohuritë e fituara t'i aplikoj në relacionet shoqërore në vendin tonë

### **Metodologjia e mësimdhënies:**

- Ligjërata
- Analiza dhe diskutime interaktive
- Prezantime të projekteve grupore dhe individuale
- Prezantimi i audio dhe video materialeve.

### **Përmbajtja e lëndës:**

**Java e parë:** Hyrje, njohja me përmbajtjen e syllabusit. Besimi në librat hyjnorë.

Domosdoshmëria e librave hyjnorë. Numri i librave hyjnorë. Fletët. Librat hyjnorë: Zeburi, Tevrati, Inxhili dhe Kur'ani.

Debat rreth krahasimit të librave hyjnorë.

**Literatura:** Prof. Bekir Topaloglu dhe të tjerë, *Bazat e besimit në islam*, përktheu: Mithat Hoxha, Prishtinë, 2002, f. 163-174. (*Në vazhdim do të mjaftohemi vetëm me cekjen e faqeve të kësaj reference*).

**Java e dytë:** Besimi në melekë. Ekzistenca dhe natyra e tyre. Veçoritë e melekëve.

Bisedë interaktive, mbi mundësinë e shfaqjes së melekëve. Detyrat e melekëve. Numri dhe llojet e tyre: Xhabraili, Mikaili, Azraili, Israfil, melekët e afërt.

Bisedë interaktive, mbi mundësinë e shfaqjes së melekëve dhe fuqinë poseduese të tyre.

**Literatura:** (f. 175-188).

**Java e tretë:** Melekët shkrues. Melekët me detyra në xhenet dhe xhehenem. Haruti e Maruti. Munker dhe Nekir. Kush janë më të lartë, melekët apo pejgamberët? Ndikimi i besimit në melek. Besimi në exhin. Shejtani. Exhini.

Diskutim rreth detyrave të melekëve në këtë dhe botën tjetër.

**Literatura:** (f. 188-199).

**Java e katërt:** Jeta e pasme-ahireti. Vdekja. Shpirti. Pas vdekjes. Shpërblimi apo ndëshkimi në varr, argumentet racionale dhe tekstuale.

Propozimi i temave për punime seminarike dhe për ese.

**Literatura:** Dr. Muhammed Enver Isa, *Nadharatun fil akidetil islamije*, bot. 3, Kajro, 1986, f. 225-236.

**Java e pestë:** Jeta e pasme (ahireti). Shpërthimi i Kiametit. Shenjat e vogla dhe shenjat e mëdha. Shenjatë e vogla të shumta në disa hadithe.

Diskutim rreth shenjave të Kiametit në kohën bashkëkohore.

**Literatura:** Prof. Bekir Topaloglu dhe të tjerë, *Bazat e besimit në islam*, f. 201-216.

**Java e gjashtë:** Shenjat e mëdha: Je'xhuxh-Me'xhuxhi, Dabetul erdi, Tymi, Dexhalli, Zbritja e h. Isait. Lindaj e diellit nga perëndimi, tri shafitjet. Ringjallja dhe mundësia e saj në aspektin racional. Ringjallja dhe realizimi i tij praktik në argumentet tekstuale islame.

Bisedë interaktive rreth ekzistimit të Je'xhuxhëve dhe Me'xhuxhëve dhe pranimit racional të ringjalljes me trup

**Literatura:** Dr. Muhammed Enver Isa, *Nadharatun fil akidetil islamije*, 1986, f. 245-253.

**Java e shtatë:** Fillimi i llogaridhënies në jetën e pasme (ahiret). Jeta pas llogaridhënies: Xhehenemi, xheneti, A'raf.

Testi i parë, studentët do të ndahen në dy grupe për mbajtjen e testit të parë.

**Literatura:** Prof. Bekir Topaloglu dhe të tjerë, *Bazat e besimit në islam*, f. 222-244.

**Java e tetë:** Doktrina mbi përkufizimin e *imanit*. Koncepti i imanit/besimit. Shkaqet e mospajtimit të doktrinave ndaj *imanit*. Argumentet e konsensusit për imanin. Argumentet e Keramitëve dhe shqyrtimi i tyre. Argumentet e Mu'tezilëve dhe shqyrtimi i tyre. Argumentet e studiuesve të hadithit dhe shqyrtimi i tyre.

Diskutim mbi këto argumente dhe krahasimi i tyre.

**Literatura:** Dr. Muhammed Xhevheri, *Akidetuna*, Kajro, 1985. f. 19-45. (*Në vazhdim do të mjaftohemi vetëm me cekjen e faqeve të kësaj reference*).

**Java e nëntë:** Komentim ndaj doktrinave mbi realitetin e imanit. Imani, shtohet apo pakësohet? Nga shenjat e imanit.

Diskutim mbi realitetin e shtimit, apo pakësimit të besimit në përditshmërinë tonë

**Literatura:** (f. 46-57).

**Java e dhjetë:** Dispozita ndaj kryesit të gjynahut të madh. Gjynahet, e mëdha dhe të vogla. Shlyerja e gjynaheve: Përkufizimi i gjynahut të madh. Doktrinat mbi dispozitat ndaj kryesit të gjynahut të madh. E para: Ehli Suneti.

Debat rreth gjynaheve në ditët e sotme.

**Literatura:** (f. 59-72).

**Java e njëmbëdhjetë:** E dyta: Doktrina Murxhi'ite. E treta: Doktrina e Havarixhëve. E katërta: Doktrina Mu'tezilite. E pesta: Doktrina e Hasan el-Basriut.

Bisedë interaktive, dhe përsëritje të leksioneve nga ora e mëparshme.

**Literatura:** (f. 73-90).

**Java e dymbëdhjetë:** Islami, kuptimi gjuhësorë. Përkufizimi i tij terminologjik dhe lidhja me imanin. Komentim ndaj dy doktrinave. Kufri, (mohimi), dhe akuzimi për kufr. Kuptimi etimologjik dhe terminologjik.

Diskutim mbi kuptimin e islamit dhe akuzimin për qufër në vendin tonë

**Literatura:** (f. 91-109).

**Java e trembëdhjetë:** Çështja e akuzimit me kufr. Mendimi i imam Gazaliut. Komentim ndaj kësaj teme. Orientimi i të përshpejtuarve me kufr

Bisedë interaktive mbi këto gjykime në vendin tonë.

**Literatura:** (f. 110-138).

**Java e katërbëdhjetë:** Orientimi i të maturve. Emrat e bukur të Allahut. Përshkrimi i emrave të Tij si të bukur në Kur'anin fisnik.

**Literatura:** (f. 138-155).

**Java e pesëmbëdhjetë:** Kuptimi i mosbesimit në emrat e të Larmadhëruarit. Numërimi i emrave të Tij të bukur. Çështje të rëndësishme të veçantë që kanë të bëjnë me emrat e bukur të Allahut.

Testi përfundimtarë, studentët do të ndahen në dy grupe për mbajtjen e këtij testi.

**Literatura:** (f. 155-167).

### **Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:**

**Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%**

**Punimi seminarik 20%**

**Testi intermedier 30%**

**Provimi final 40%**

**Total 100%**

### **Literatura obliguese:**

1. Prof. Bekir Topaloglu dhe të tjerë, *Bazat e besimit në islam*, përktheu: Mithat Hoxha, Prishtinë, 2002,

### **Literatura shtesë dhe bibliografia:**

1. *Pesë kryeveprat e Ebu Hanifes*, përktheu: Mustaf Bajrami, Prishtinë, 2000
2. Veliu, dr. Galip; *“Zoti në metafizikë, shkencë, Kur’an”*, Gostivar, 1998